

Programi i resurseve natyrale

A dëshiron të punosh me kafshët dhe natyrën?

A dëshiron të kërkojsh punë menjëherë pas gjimnazit?

A dëshiron të keshë mundësi të punosh apo studijosh jashtë vendit?

A dëshiron të keshë një kualifikim të gjërë dhe njëkohësisht të zhvillosh interesimet e tua të aktiviteteve të kohës së lirë?

Në atë rast, Programi i resurseve natyrale mund të jetë për ty.

Te Programi i resurseve natyrale do të mësosh dituri të gjëra për kafshët, natyrën dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Por do të jepet poashtu mundësia që të mirresh me diçka që më parë ndoshta ka qenë një interes i aktiviteteve të kohës së lirë, si kuajt, punët e kopshtit ose gjahu dhe peshkimi. Në këtë mënyrë mund të përgatitesh që të keshë hobin tënd si punë, ose do të duhet të mësosh edhe ca kurse shtesë me qëllim që të kërkojsh të pranohesh në fakultet.

Është shumë e zakonshme që ata që punojnë me kafshët dhe natyrën të kenë sipërmarrjen e tyre private. Për këtë arsye do të duhet të mësosh për ekonomi dhe performancë kompanishë.

Resurset natyrale janë diçka që gjinden në tërë botën. Me dituri gjuhësore edhe me kuptim dhe interesim për kultura tjera, ke mundësi të mira që të punosh apo studijosh jashtë vendit pas përfundimit të Programi i resurseve natyrale.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e resurseve natyrale mund të kërkojsh punë menjëherë pas gjimnazit. Por ti mund të zgjedhësh që t'i vazhdosh studimet. Mund të zgjedhësh një kualifikim tek Fakulteti i profesioneve ose në një kualifikim më të shkurtër të shkollës së lartë të Universiteti i Suedisë për Bujqësi (SLU).

Te Programin i resurseve natyrale mund të zgjedhësh kurse që të japin kompetencë të diturive me drejtim të shkencave natyrore. Në atë rast do të mund të të kërkojsh të pranohesh në kualifikime tjera dhe më të gjata të Fakulteti i profesioneve dhe në universitet. Ndoshta shkolla yte ka një drejtim që të jep kompetencë të diturive me drejtim të shkencave natyrore. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që i ke përfunduar studimet të Programi e resurseve natyrale mund të kërkojsh disa nga punët menjëherë. Mundesh për shembull të kërkojsh të punosh si për shembull kujdestar kujash, me kafshë në bujqësi, në parqet e kafshëve, në shëndetësi për kafshë, kultivim, kopshte, fusha golfi, pylltari, gjah, përkujdesje të kafshëve të egra, ujë dhe peshkim.

Përmbajtja e Programit

Programi i resurseve natyrale përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë veçanta për Programin e resurseve natyrale. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi nuk ka drejtime ndërkombëtare. Në vend të tyre, çdo shkollë ka mundësi që të krijojë drejtimet e veta. Shembuj të drejtimeve janë trualli, pyjet, kopshtet, shëndetësi për kafshët, mbajtje të kuajve, ujë dhe peshkim, gjah dhe përkujdesje për kafshët e egra, përkujdesje të ambinetit edhe të natyrës dhe turizëm në natyrë.

Ti ndoshta ke ndonjë interesim të veçantë për të cilin mund të jetë e mundur të studijosh në një vend tjetër? Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve në rast se drejtimi është i përfshirë te programi shtetëror. Në atë rast do të keshë mundësi që të pranohesh tek drejtimi.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi i resurseve natyrale do të kesh kontakte me tregun e punës që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Vendi i punë që do të caktohet varret nga drejtimi që e ke zgjedhur. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijosh kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Kompanitë për bujqësi, kopshtet dhe kujdestarët e pyjeve kanë nevojë për personel të ri, por ata ndoshta nuk kanë nevojë të punësojnë edhe aq shumë. Nëse bëhet e lehtë apo e vështirë për ty që të punësoshesh varret nga drejtimi që e ke zgjedhur dhe se në rast se je në gjendje që të shpërngulesh ose të udhëtosh me qëllim që të punësohesh. Nëse i vazhdon studimet pas gjimnazit mund të jetë më e lehtë të gjejsh punë. Nëse që tani e di se me çka dëshiron të punosh në ardhmëri, ndoshta do të jetë e mundur që të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri.